



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 DEPARTAMENTI I DREJTARISIA / DEPARTMENT OF LEGAL AFFAIRS
 DEPARTAMENTI I DREJTARISIA / DEPARTMENT OF LEGAL AFFAIRS

Dep. _____
 Dep. _____
 Dep. _____

Nr. Prot. _____
 Nr. Prot. _____

Nr. I faq. _____
 Broj stranica _____
 Nr. pages _____

PRISHTINE

03-02/5887/16
 20.10.2016

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.10.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2960/16, për z. Fejzi Kiqina, Anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Fejzi Kiqina, Anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat Sh.P.K "Kling Kamion Kosova", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Kiqina është njoftuar me fakte për kufizimin e përcaktuar shprehimisht në Ligjin nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni (15 paragrafi 1), në të cilin shprehimisht thuhet:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private".

Zyrtari i lartë ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Kiqina ka dërguar në Agjenci shkresen zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/3636/16), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin e lartëcekur. Me këtë rast z. Kiqina e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

